



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 65, datë 02.10.2018

PËR SHITESË FONDI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 02.10.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 35 pika 1 shkronja “d”, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 20 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat statndarte të zbatimit të buxhetit, udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.1.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, udhëzimit nr. 8, datë 17.2.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donator të huaj, ligjin nr. 132/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin kuadër “HORIZON 2020-Programi për kërkim dhe inovacion”, Deklaratën për miratimin e termave dhe kushteve të portalit të pjesëmarrjes prot 2085, datë 9.2.2018, termat dhe kushtet e përcaktuara në portalin pjesëmarrës Horizon 2020, letrën për emërimin e LEAR prot 2086, datë 9.2.2018, shkresën nr. 3229 prot, datë 28.2.2018 “Për vazhdimin e procedurave për zbatimin e projektit sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në portalin pjesëmarrës të programit Horizon 2020, Marrëveshjes së Grantit nr. 769072 PARCK4SUMP prot. 9419, datë 13.6.2018, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2018-2020 të bashkisë Shkodër”,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit në buxhetin e bashkisë Shkodër me burim financimi donacion në llogari jashtë llogarive të thesarit, me afat 42 muaj nga data e fillimit të projektit 1 Shtator 2018, në programin 6260 “shërbime publike”, zëri “investime”, në shumën **29,422.50 Euro** (njëzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e dy pike

pesëdhjetë), konvertuar në lek sipas kursit të këmbimit të ditës që do të transferohet fondi, me burim financimi Programi Horizon 2020.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 20.08.2018


Shpallur në datën 22.08.2018

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhema BUSHATI

Pr. 17459

22.10.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT SHKODËR
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 1232/1 prot

Shkodër, më 18.10.2018

LËNDA: Lidhur me vendimin nr. 65, datë 02.10.2018 të Këshillit Bashkiak Shkodër

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin", neni 8, gërma a, të ligjit nr. 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", neni 35, pika 1, shkronja d, neni 36, pika 2, neni 54, pika dh, neni 55 pika 3. të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", neni 20, të ligjit nr. 9963, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", pika 190, të Udhëzimit MF nr. 8, dt. 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrveshjeve me donator të huaj", të ligjit nr. 132/2014 "Për ratifikimin e marrveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin kuadër "Horizon 2020-Programi për kërkim dhe inovacion", të VKB nr. 85, datë 26.12.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2018-2020", shqyrtoi **VKB Shkodër nr. 65, datë 02.10.2018 " Për shtesën e fondit prej 29,422.50 euro, në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB Shkodër 85/2017, në prog.6260/shërbime publike, me burim financimi Programi për kërkim dhe inovacion, Horizon 2020"**.

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedimin e mëtejshëm.

Me respekt,

P R E F E K T I

Çesk MILLJA

